

# VJOSA LUGINA QË BASHKON NJERËZIT

# VJOSA

## LUGINA QË BASHKON NJERËZIT

Lumi Vjosa është një nga lumenjtë e fundit natyrorë në Evropë. Përgjatë gjithë rrjedhës së tij prej mbi 270 kilometra lumi është i paprekur dhe rrjedh i lirë, me larmi tiparesh hidro-morfologjike. Së bashku me degët e saj, Vjosa përbën një ekosistem dinamik thuajse natyror, të rrallë për Evropën.

Lugina e Vjosës shtrihet në jug të Shqipërisë në një lartësi mesatare 855 m.n.d. Rrjeti hidrografik i sistemit lumor të Vjosës rrjedh përmes masiveve para-malore e malore, me lartësi maksimale mbi 2600 m.n.d.

### POPULLSIA

Me ndarjen territoriale të vitit 2014 lugina e Vjosës shtrihet në qarqet **KORÇË (8.75%)**, **GJIROKASTËR (50.47%)**, **VLORË (30.59%)**, **FIER (10.13%)**, **BERAT (0.06%)**.

Pjesa më e madhe e popullsisë në luginën e Vjosës është rurale. Bazuar në censusin e vitit 2011 popullsia në basenin e Vjosës ishte 184,781 banorë. Mbi 70% e popullsisë është vendosur në rrjedhën e poshtme.



© GERNOT KUNZ

### BIODIVERSITETI

Lugina e Vjosës zë pothuajse 16% të territorit të Shqipërisë. Megjithëse mungojnë studimet e thelluara, kjo pjesë e vendit konsiderohet se bart vlera të larta të biodiversitetit. Habitatet natyrore në këtë ekosistem krijojnë mundësinë e një vijueshmërie ekologjike duke strehuar një biodiversitet të pasur. Për këtë arsye përgjatë luginës janë shpallur rreth 10 zona të mbrojtura dhe afro 130 monumente natyre. Për sa i përket numrit të llojeve, nuk ka një inventarizim të tyre në të gjithë luginën, por supozohet se pellgu ujëmbledhës i Vjosës strehon pjesën më të madhe të taksonëve të biodiversitetit të Shqipërisë duke përfshirë shumë lloje të rrezikuara dhe endemike.

Ndërtimi i HEC-eve është kërcënimi aktual më i madh në këtë zonë. Një total prej rreth 42 HEC-esh janë parashikuar në ujëmbledhësin e Vjosës në Shqipëri. Ndërtimi i digave është ndërhyrja më shkatërruese që mund të rezultojë me pasoja të pakthyeshme në mjedis duke dëmtuar në mënyrë përfundimtare integritetin natyror të këtij ekosistemi unik. HEC-et pengojnë rrugët e migrimit të peshqve, transportin e sedimenteve dhe përbëjnë një ndër faktorët kryesorë të ndryshimeve mikroklimatike.

**Në aspektin social ndërtimi i HEC-eve në luginën e Vjosës është shoqëruar me kundërshti të fortë të banorëve të cilat vijnë si pasojë e disa faktorëve kryesorë:**



© BESJANA GURI

- a) mungesa e informimit dhe konsultimit / konsultime fiktive**
- b) e drejta për përdorimin e ujit**
- c) shkatërrimi i mjedisit**
- d) përmbytjet e tokave bujqësore**

Faktorët e mësipërm kanë shtyrë komunitetin e luginës së Vjosës të prekur nga ndërtimi i HEC-eve në forma të ndryshme të reagimit qytetar si: ankimime administrative, peticione (4), protesta qytetare(10), ankimime në gjykatë(1). Në jo pak raste banorët nga zona të ndryshme të luginës janë solidarizuar mes tyre duke ndërmarrë aksione të përbashkëta kundër ndikimeve që sjellin HEC-et direkt në jetën dhe ekzistencën e tyre.

Kërkesat e tyre kanë gjetur mbështetjen e Njësive të Qeverisjes Vendore, Kryetarët e të cilave së bashku i kanë adresuar një letër të hapur Qeverisë Qendrore me kërkesë: “Mos- ndërtimin e HEC-eve në Vjosë dhe shpalljen e saj Park Kombëtar për një zhvillim të qëndrueshëm”.

Në rastin e HEC-it të Poçemit, banorët e fshatit Kutë, së bashku me organizatat për mbrojtjen e natyrës, kanë paditur Ministrinë e Mjedisit dhe Ministrinë e Energjisë në Gjykatën Administrative, duke shënuar rastin parë të një çështje mjedisore në gjykatë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë në Tiranë ka vendosur në favor të banorëve.



# KALIVAÇI

Rrjedha e mesme e Vjosës përbën një nga zonat më dinamike të lumit. Në këtë zonë shtrati zgjerohet në mbi 2 km. Pikërisht në këtë pjesë të lumit, pranë fshatit Kalivaç, është projektuar të ndërtohet HEC-i me të njëjtin emër.



## HEC-I I KALIVAÇIT

Projekti i Kalivaçit është hidrocentrali i parë në Vjosë i dhënë në vitin 1997. Ndërtimi i digës ka filluar në 2007, por është ndërprerë disa herë. Fillimisht, burimi kryesor i financimit ishte investitori italian Becchetti Grup dhe Deutsche Bank, por punimet kanë shkuar deri në nivelin 30 % duke e lënë lumin ende të paprekur. Kompania italiane ka pasur gjithashtu probleme të vazhdueshme likuidimi me kompanitë nënkontraktore, të cilët kanë braktisur punimet. Në vitin 2017 qeveria Shqiptare ka anuluar kontratën e koncesionit me kompaninë italiane “Kalivac Green Energy” të investitorit Francesco Bechetti dhe ka rinisur procedurat për hapjen e tenderit për ndërtimin e HEC-it të Kalivaçit.

Hydrocentrali i Kalivaçit do të mbulojë rreth 16 km të rrjedhës së lumit Vjosa, me një digë 45,8 m të lartë dhe 500m të gjatë me një kapacitet 100MW. Rezervuari që do të formohet parashikohet të mbulojë rreth 1700ha tokë me vëllim 350 milion m<sup>3</sup>, i cili do të shkaktojë përmbytjen e 128 banesave në 5 Njësi Administrative ku më të rrezikuarat janë Krahës dhe Qesarat.

## ANGAZHIMI I KOMUNITETIT

Banorët e fshatrave Lopës, Qendër dhe Memaliaj kanë protestuar (3 protesta) kundër ndërtimit të hidrocentralit të Kalivaçit, pasi nuk ngelën të kënaqur nga qeveria shqiptare nga vlera e përcaktuar për dëmshpërblim e shpronësim (2 euro/m<sup>2</sup>). Nga kundërshtimet e protestuesve (Banorëve) kanë rezultuar edhe raste konfliktuale, ku konkretisht për HEC-in e Kalivaçit janë arrestuar 4 persona. Shkaku i konflikteve ka qenë mungesa e pagesave dhe mosrespektimi i kontratës, ndaj banorët kanë zgjedhur protestën civile si formë reagimi. Peticionet dërguar autoriteteve kanë qenë gjithashtu një nga mjetet e përdorura nga banorët për ngritjen e shqetësimeve të komunitetit.





# POÇEMI

Në zonën e Poçemit lumi krijon habitatet e veçanta me bimësi aluvionale dhe gjithashtu ofron toka pjellore për banorët që jetojnë përgjatë tij. Të ardhurat kryesore të banorëve të fshatrave përreth bazohen kryesisht në zhvillimin e bujqësisë. Hidrocentrali i dytë i madh në Vjosë është ai i Poçemit dhe diga e tij planifikohet të ndërtohet pranë fshatit Poçem.



## HEC-I I POÇEMIT

Projekti i hidrocentralit të Poçemit parashikon ndërtimin e një dige rreth 25m të lartë, 200m të gjatë dhe me kapacitet 102,2 MW. Diga e HEC-it do të krijojë një rezervuar prej 24 km<sup>2</sup>, i cili do të përmbytë rreth 2000 ha tokë bujqësore, në fshatrat: Kutë, Çorrush, Anëbreg dhe Drizar të Bashkisë Mallakastër dhe fshatrat Shkozë, Sevaster, Karabonarë të Bashkisë Selenicë.

Koncesioni për ndërtimin e këtij hidrocentrali i është dhënë kompanisë turke “Kovlu Enerji” në shtator 2016.

## ANGAZHIMI I KOMUNITETI

Procesi i konsultimit të publikut në rastin e Poçemit ka pasur disa shkelje:

(i) kompania nuk ka realizuar një dëgjese publike me komunitetin e prekur dhe banorët janë informuar mbi këtë projekt vetëm përmes medias dhe punës së OJF-ve.

Pas kërkesave të shumta për informacion, ka rezultuar se dëgjesa me publikun është bërë në Fier me rreth 50 pjesëmarrës, ku asnjëri prej

tyre nuk është banor i zonave të prekura.

(ii) Njësitë e Qeverisjes Vendore nuk janë informuar për projektin dhe nuk janë bërë pjesë e procesit të konsultimit publik.

Nisur nga ky fakt, banorët kanë nënshkruar një peticion të përbashkët, drejtuar Qeverisë Qendrore, kundër ndërtimit të hidrocentralit të Poçemit, por nuk kanë marrë asnjë përgjigje. Të revoltuar nga mungesa e transparencës, informimit dhe përfshirjes në vendim-marrje, vetëm në vitin 2016, banorët janë përfshirë në 7 protesta kundër HEC-it të Poçemit duke përshkallëzuar reagimin e tyre deri në bllokimin e rrugëve nacionale.

38 banorë dhe 3 OJF-të që punojnë për mbrojtjen e Vjosës kanë hapur procesin gjyqësor duke kërkuar anulimin e kontratës për HEC-in e Poçemit. Më 2 maj 2017 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë në Tiranë ka vendosur në favor të tyre, duke shpallur të pavlefshme kontratën koncesionare të lidhur mes Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe kompanisë turke “Kovlu Enerji”.





# LANGARICA

---

Langarica është një nga degët e lumit Vjosa, e cila ndodhet në pjesën e sipërme të luginës pranë qytetit të Përmetit. Kjo zonë me vlera të jashtëzakonshme natyrore dhe turistike përfshin **burimet e banjave termale të Bënjës** (8 të tilla në total), **Kanionin 7 km të Langaricës**, Urën otomane të Katiut, pyllin dhe shpellat e Petranit, kishën e Bënjës dhe shumë burime të tjera, të shpallur Monumente Natyrore dhe Kulturore.





## HEC-ET NË LANGARICË

Përgjatë lumit Langaricë janë planifikuar të ndërtohen 6 HEC-e, 2 prej të cilave kanë përfunduar, ndërsa një është në ndërtim e sipër. 3 HEC-et janë brenda “Parkut Kombëtar të Bredhit të Hotovës”. HEC-i më i kontestuar është HEC Langarica 3, i ndërtuar nga kompania austriake “Enso Hydro” me kapacitet 8,6 MW. Uji për të prodhuar energjinë merret me anë të një tuneli 7 km të gjatë nga burimi i lumit.



© ROLAND TASHO

## ANGAZHIMI I KOMUNITETIT

Konçesioni për ndërtimin HEC Langarica 3 është dhënë vitin 2010 dhe ka rezultuar të jetë problematik.

(i) Në vitin 2013 kompania austriake “Enzo Hydro” ka zhvilluar konsultimin publik me komunitetin ku pjesëmarrja ka qenë shumë e kufizuar (më pak se 10 persona). Banorët dhe OJF-të nuk janë bërë pjesë e procesit të konsultimit

(ii) Njësitë e Qeverisjes Vendore (më parë komunat), Petran, Lunxhëri dhe Pogon, kishin tjetër vizion për zhvillimin e zonës, atë të zhvillimit të turizmit.

Duke vlerësuar ndikimet negative që ky HEC do të kishte në zonë, banorët kanë reaguar nëpërmjet protestave dhe peticioneve. Fillimisht, reagimi nga Ministria e Mjedisit ka rezultuar në refuzimin e Lejes Mjedisore, e cila është rinovuar vetëm një javë pas refuzimit. Ky fakt ka nxitur OJF-të të ngrenë një padi në prokurori me objekt: shpërdorim detyre. Megjithatë çështja është pushuar nga Prokuroria e Tiranës për mungesë të provave të mjaftueshme. Komuniteti ka kundërshtuar ndërtimin e këtyre HEC-eve që në fillim duke u mbështetur fuqishëm edhe nga banorët e Përmetit.

Njësitë e Qeverisjes Vendore kanë refuzuar të japin dakordësinë për këtë projekt, duke shprehur edhe shqetësimin e banorëve nëpërmjet shkresave drejtuar Qeverisë Qendrore.

Pavarësisht kundërshtimit të vazhdueshëm, hidrocentrali i Langaricës është përfunduar në vitin 2015.

# LUGINA E BËNÇËS

Lumi i Bënçës **[26 km]**, një nga degët më piktoreske të Vjosës, formohet nga bashkimi i Gurrës së Progonatit me përroin e Nivicës duke përshkuar kanionet e Bënçës, një ekosistem tipik me vlera të mëdha biologjike natyrore.





## HEC-ET NË LUGINËN E BËNÇËS

Në luginën e Bënçës janë parashikuar të ndërtohen 8 HEC-e, përkatësisht: Meshaniku, Guva, Driza 1, Driza 2, Lekdushi, Progonati, Bënça e Sipërme, Bënçë-Tepelenë, 2 prej të cilave kanë filluar punimet (pranë fshatit Bënçë). Të 8 HEC-et së bashku do të kenë një kapacitet rreth 25 MW. Ndërtimi i këtyre HEC-eve rrezikon monumentet natyrore dhe potencialin për zhvillimin turistik të gjithë zonës.

Disa prej kanioneve të luginës së Bënçës janë shpallur monumente natyrore nga të cilat të mbrojtura me ligj janë: Kanionet e Nivicës, Ujëvara e Progonatit, Tarraca erozive e Bënçës dhe Buza e Bredhit Luzat. Gjithashtu ndodhen edhe dy objekte monument kulture si: Ura e “Ali Pashë Tepelenës” dhe Mekamet ose Teqeja e “Baba Shehut”.



© ROLAND TASHO

## ANGAZHIMI I KOMUNITETIT

Një nga HEC-et që ka sjellë më shumë kundërshti në komunitet është HEC-i Bënçë-Tepelenë, pranë fshatit Bënçë.

Kontrata për ndërtimin e HEC-it Bënçë- Tepelenë është aprovuar në vitin 2009. Ndërsa konsultimi me komunitetin është realizuar në vitin 2013 me disa përfaqësues të fshatit Bënçë.

Banorët janë informuar mbi një projekt komplet të ndryshëm nga ai që ka filluar të zbatohet nga kompania në vitin 2013.

Projekti realisht konsistonte në devijimin e lumit përmes një tuneli i cili do të shkaktonte tharjen e shtratit të lumit, duke ndikuar direkt në jetën e banorëve dhe duke çenuar potencialin për zhvillimin e turizmit në zonë.

Fillimi i punimeve është shoqëruar me kundërshtimin e banorëve dhe reagimin e tyre nëpërmjet peticioneve, shkresave, protestave (3) dhe daljes në mediat lokale dhe kombëtare. Nëpërmjet shkresave dhe peticioneve, ata kanë kërkuar rishqyrtimin e dokumentacionit të projektit dhe Lejes Mjedisore. Ndërsa me anë të protestave kanë synuar ndalimin e punimeve deri në një konsultim të dytë me komunitetin.

Në 2017 banorët kanë nënshkruar një peticion të ri ku tashmë kërkojnë anulimin e HEC-eve në Bënçë dhe synojnë të kundërshtojnë HEC-in Bënçë- Tepelenë në rrugë gjyqësore.

# LUGINA E DRINOS

Lumi Drinos **[84 km]** i cili përshkon qytetin e Gjirokastrës është një nga degët kryesore të lumit Vjosa dhe buron nga Mali i Elates në Greqi. Ai rrjedh midis dy vargmaleve, nga njëra anë Shëndëlli – Lunxhëri – Bureto dhe nga ana tjetër Malësia e Kurveleshit – Mali i Gjerë – Stugarë. Lugina e Drinos zonë e pasur me objekte, rrënoja dhe gjurmë vendbanimesh antike, bizantine dhe mesjetare, gjithashtu shquhet për një numër të madh manastresh.

## HEC-ET NË LUGINËN E LUMIT DRINOS

Në të gjithë luginën e Drinos janë planifikuar 6 HEC-e, ku dy janë në vetë lumin Drinos dhe katër të tjerë në degët e tij, lumi i Suhës dhe përroi i Kardhiqit. Sipërfaqja ujëmbledhëse e Drinos është 256km<sup>2</sup>.

## ANGAZHIMI I KOMUNITETIT

Për shkak se ndërtimi i HEC-eve në luginën e Drinos është në faza të hershme nuk ka pasur një angazhim të komunitetit në zonat ku do të ndërtohen këto HEC-e. I vetmi projekt i përfunduar është ai i lumit të Kardhiqit. HEC-i shfrytëzon ujërat dhe kanalin e devjimit të ish-ndërmarrjes së shtimit të troftës dhe kapaciteti i instaluar është më i vogël se 1MW. Gjurma mjedisore e tij është e vogël dhe nuk prek drejtpërdrejt interesat e banorëve, për këtë arsye nuk ka pasur ndonjë reagim. Megjithatë ndërtimi i disa HEC-eve përgjatë rrjedhës do të sillte zmadhimin e ndikimit në funksionimin e ekosistemit. Projektet për HEC-et e tjera në Suhë dhe mbi vetë lumin Drinos janë në fazë planifikimi dhe nuk i janë nënshtruar ende procesit të konsultimit me komunitetin.





# LUGINA E SHUSHICËS

Shushica **[81,6 km]**, një nga degët kryesore të lumit Vjosa, rrjedh në jugperëndim të rrethit të Vlorës dhe buron nga Mali i Thatë dhe Mali i Gjoshnikoshit në lindje të fshatit Kuç. Njihet ndryshe si lumi i Vlorës me degët kryesore të tij përroin e Smokthinës, Vajzës dhe të Vllahinës.


## HEC-ET NË LUGINËN E SHUSHICËS

Në luginën e Shushicës janë planifikuar të ndërtohen 6 hidrocentrale, 2 nga të cilat do të ndërtohen mbi përroin e Smokthinës ndërsa 4 të tjerë janë mbi vetë Shushicën. I vetmi HEC ekzistues është ai në afërsi të fshatit Lepenicë. Fuqia e instaluar për gjithë kaskadën e hidrocentraleve në luginën e Shushicës do të jetë 14,9 MW.

## ANGAZHIMI I KOMUNITETIT

Zona e lumit të Vlorës është një ndër zonat që është prekur më së shumti nga fenomeni i emigracionit si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Megjithatë banorët që jetojnë aty bazojnë aktivitetin e tyre bujqësor dhe blegtoral në shërbimet e këtij ekosistemi lumor. Nga ana tjetër zona ofron një ekosistem pothuajse natyror me një ndërthurje të vlerave historike dhe peizazhore. Investimet që lidhen me përmirësimin e infrastrukturës rrugore i japin një mundësi më shumë zonës për zhvillimin e potencialit të saj të orientuar drejt eko-turizmit. Planet për ndërtimin e HEC-eve mund ta dëmtojnë që në fillim këtë orientim megjithatë për aq kohë sa planet janë në faza shumë të hershme komuniteti lokal ende nuk është përfshirë në këtë proces.







## VIZIONI:

Vjosa përbën një ndër ekosistemet më unike të kontinentit Evropian me vlera të jashtëzakonshme të biodiversitetit. Nga ana tjetër kjo luginë bart të gjitha potencialet e një zhvillimi të qëndrueshëm që do të sillte një shpërndarje të ekuilibruar të përfitimeve në komunitet. Për këtë arsye aktorët e përfshirë në mbrojtjen e kësaj trashëgimie natyrore, duke përfshirë banorët, njësitë e qeverisjes vendore të luginës, OJF-të kombëtare dhe ndërkombëtare, rrethet shkencore shqiptare dhe ndërkombëtare e shumë personalitete të shquara propozojnë si alternativë shpalljen e Vjosës Park Kombëtar! Në këtë mënyrë Vjosa mund të jetë Parku i parë Kombëtar i një lumi natyror në Evropë.

Megjithatë, një Park Kombëtar mund të quhet i tillë vetëm duke mos lejuar ndërtimin e HEC-ve. Veprimtari të tilla si eko-turizmi apo bujqësia jo-intensive mund të jenë alternativa efektive për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të zonës.





© ROLAND DOROZHANI

QERSHOR 2017

VJOSA - LUGINA QË BASHKON NJERËZIT

Kjo broshurë është prodhuar në kuadër të projektit “AKTIV- Angazhimi i Komunitetit-Tregues i Integritimit në Vendim-marrje” dhe financohet nga LëvizAlbania – për një demokraci të fortë vendore nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim – SDC’.



“Projekti AKTIV- Angazhimi i Komunitetit – Tregues i Integritimit në Vendim-marrje: i cili zbatohet nga EcoAlbania, ka si qëllim rritjen e pjesëmarrjes aktive të publikut në vendim-marrje, për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.”



**PËR MË SHUMË INFORMACION:**  
[www.aktiv.ecoalbania.org](http://www.aktiv.ecoalbania.org)  
 e-mail: [contact@ecoalbania.org](mailto:contact@ecoalbania.org)  
 Tel.: +355 44 31 720



Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e EcoAlbania dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton pozicionin e qendrës Lëviz Albania”.



[www.ecoalbania.org](http://www.ecoalbania.org)